



RAPORT I VITIT 2020 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka realizuar planin e saj të konsultimit publik të akteve sipas parashikimeve në Programin e Përgjithshëm Anatik të Projektakteve për vitin 2020, duke realizuar procesin e konsultimit publik për 1 (një) projektligj (*projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2017 "Për sportin"*). Nga analiza e kryer pas përfundimit të konsultimeve rezulton që ka një numër shumë të pakët të komenteve/sugjerimeve nga publiku. Kemi marrë komente/sugjerime vetëm nga aktorë të përfshirë drejtpërdrejt në proceset sportive, të ardhura kryesisht nëpërmjet takimeve të grupeve të punës dhe komenteve/sugjerimeve të ardhura me postë. Këto komente sugjerime janë përfshirë në masën 100% në procesin e vendimmarrjes, duke u integruar në tërësi në përmbajtjen e projektligjit.

Një nga faktorët kryesorë që ndikon në angazhimin e pakët të publikut në këto procese, është mungesa e informacionit lidhur me zhvillimin e proceseve të konsultimit publik dhe metodave konkrete të konsultimit të përdorura. Gjithashtu, arsye tjetër e pjesëmarrjes së ulët mund të jetë edhe mungesa e besimit të qytetarëve në përgjithësi lidhur me mundësinë e ndikimit efektiv të opinionit të tyre në procesin e vendimmarrjes. Kjo frymë passjell procese konsultimi inefficente dhe kjo jo për shkak se nga ana e institucioneve mungon vullneti për përfshirjen e publikut në proces.

Nga monitorimi i regjistrimit elektronik të konsultimit publik, rezulton se nuk ka pasur vizitorë në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve Publike dhe për rrjedhojë as komente të ardhura nga kjo metodë konsultimi.

Nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik mbetet një nga sfidat kryesore të gjithë administratës publike në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik, si një hallkë thelbësore në zinxhirin e procesit të hartimit të legjislacionit.

2. Analiza e konsultimeve të kryera në katërmujorin e parë të vitit 2020

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.837, datë 24.12.2019 “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020”, i ndryshuar ka planifikuar për të propozuar për miratim 26 (njëzet e gjashtë) projektakte, prej të cilave 1 (një) projektligj (3.8%) dhe 25 (njëzet e pesë) projektvendime (96.2%).

Gjatë të gjithë vitit janë planifikuar të zhvillohen konsultime publike për 1 (një (100%) projektligj nga 1 (një) në total. Pjesa tjetër përbëhet nga projektvendime që bien në fushën e përjashtimeve bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ligji nuk përcakton detyrime për zhvillimin e konsultimit publik për projektvendime, me përjashtim të rasteve ku nëpërmjet tyre miratohen “dokumente strategjike kombëtare”.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin””, i është nënshtruar procesit të vlerësimit të ndikimit, VNR, dhe është parashikuar në pikën 1 të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2020. Sfera e veprimtarisë që mbulon ky projektligj nuk bën pjesë në parashikimet e përfshira në Planin Kombëtar për Integrimin European 2019-2021, miratuar me VKM-në nr.201, datë 10.04.2019.

Gjatë vitit 2020 është zhvilluar konsultim publik për 1 (një) projektligj (100%).

2.2. Metodatat e konsultimit

Për të zhvilluar konsultimet publike nga ana u përdoren këto metoda: i) Publikimi i draftit të projektligjit në Regjistrin Elektronik; ii) Njoftimi dhe Konsultimi; iii) Publikimi i draftit në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (të gjitha komentet/sugjerimet mund të dërgoheshin në adresën e e-mailit të hapur për këtë qëllim: (edmond.ahmeti@arsimi.gov.al dhe voltisa.koci@arsimi.gov.al) dhe zhvillimi i takimeve publike.

Konkretisht, për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”” për të cilët konsultimi publik është mbyllur, kemi bërë publikimin në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/253>, dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë: <https://arsimi.gov.al/projektligj-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-ligjin-nr-79-2017-per-sportin/>. Për projektligjin kemi marrë komente me email dhe kërkesa me postë drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pasi ishin njohur me projektligjin nëpërmjet faqes zyrtare të MASR. Numri total i komenteve të marra ka qenë 15, të ardhura nga takimet e realizuara me palët e interesuara dhe nga komentet/sugjerime të ardhura me postë dhe postë elektronike.

Nga konsultimet publike të kryera më së shumti kemi marrë komente/sugjerime me postë dhe postën elektronike dhe me takimet. Nisur nga ky fakt, kjo metodë konsultimi rezulton të jetë metoda më efikase, duke pasqyruar dhe numrin më të madh të komenteve të marra, në total 15 komente.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

Në çdo rast konsultimi publik ka qenë i hapura për të paktën 3 (tre) muaj. Afati mesatar për kohëzgjatje e konsultimit publik është 20-40 ditë, në bazë të legjislacionit në fuqi.

2.4. Palët e interesit të përfshira

Në grupet e punës për hartimin e akteve kanë marrë pjesë personeli i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Grupi ndërinstitucional i punës i ngritur me urdhrin nr. 57, datë 25.3.2019, të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Ndërinstitucional për Reformën në Sport”. Gjithashtu kanë dhënë komentet e tyre gjatë takimeve publike edhe përfaqësues nga Policia e Shtetit, Agjencia e Shërbimit të Sportit etj.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

Nga realizimi i procesit të konsultimit publik morëm komente për projektligjin, nga të cilat erdhën disa sugjerime, të cilat u vlerësuan të drejta dhe u morën parasysh nga personat përgjegjës, që u përkasin strukturave të sportit. Konkretisht, janë marrë 15 komente/sugjerime, të cilat janë pranuar të gjitha duke bërë dhe reflektimet përkatëse në tekstin e projektligjit.

Ky fakt u konsiderua prej nesh një përmirësim në kuadër të rritjes së përfshirjes së publikut në procesin e dhënies së mendimeve/sugjerimeve mbi projektaktin që hartohet nga ana e institucioneve.

2.6. Rezultatet e raporteve të konsultimeve

Konsultimi publik ka përfunduar për projektligjin, e planifikuar për konsultim dhe është finalizuar me miratimin e ligjit nr. 105 datë 29.07.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”.

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësitë për të ardhmen

Sfida kryesore mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, nëpërmjet

dhënies së mendimeve/sugjerimeve kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit.